

Mbi

Auditimin e Brendshëm

Ushtruar në Drejtorine e Sherbimeve Bujqesore e Pyjore

Njesia e Auditimit Brendshem – Bashkia Shkoder bazuar ne ligjin 114/2015 “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Per miratimin e kriterëve per ngritjen e Njesive te Auditimit te Brendshem ne sektorin publik”, zhvilloi nje mison auditimi te plote ne Drejtorine e Sherbimeve Bujqesore e Pyjore – Bashkia Shkodër, per periudhen 01.01.2016 deri me 30.12.2016 nga auditimi rezultoi:

Permbledhje ekzekutive

Drejtoria e Sherbimeve Bujqësore e Pyjore eshte institucion varesie. Gjate auditimit jane konstatuar mangesi ne funksionimin e kontrollit te brendshem, kryesisht ne vendosjen e objektivave, ne pershkrimin e proceseve te punes ne kontrollin e aktivitetëve. Ka pasur mangesi ne mbledhjen dhe dokumentimin e tarifave bazuar ne shfrytëzimin e sipërfaqëve të fondit pyjor dhe lëndës drusore për vitin 2016, nuk ka mbajtur akt-rakordime me drejtorine e te ardhurave per tarifat e arketuara. Ka pasur pasaktësi në llogaritjen e pagave, në hartimin e pasqyrave financiare,në realizimin e procedurave të blerjeve me vlera të vogla.Nuk ka bashkepunuar me drejtorite prane Bashkise Shkoder dhe Njesitë Administrative për kontrollin dhe menaxhimin e territorit dhe shfrytëzimin nga të tretë te siperfaqëve pyjore e bujqësore. Ka mangesi ne menaxhim,monitorim,informim dhe raportim te aktivitetiteve te drejtorisë,si dhe në ndjekjen e regjistrit të rrishtit.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1.Gjetje Referuar ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, perkatesisht neni 11, Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore,duhej te ishin përcaktuar qarte objektivat, duhej të kishte perpiluar dhe miratuar rregulloren e brendshme, pershkrimet e e punes sipas vendeve te punes, duhej të ishte përcaktuar qartë funksionimi i kontrollit të brendshëm, duhej të ishte perpiluar regjistri i rrishtit, duhej te ishte ngritur grupi i menaxhimit strategjik.

Nga auditimi i kryer ka rezultuar se kjo drejtori nuk ka rregullore te brendshme funksionimi , nuk është bërë pershkrimi i punes sipas vendeve të punës, nuk është perpiluar regjistri i rrishtit,nuk ka percaktuar objektivat,nuk është dokumentuar funksionimi i kontrollit te brendshem,nuk jane percaktuar linjat e raportimit. Këto veprime bien në kundërshtim me nenin 11 i ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Rekomandime Ne bashkepunim me Drejtorine e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP ,te behet hartimi I rregullores se brendshme te funksionimit, bazuar ne manualin e kontrollit te brendshem te sektorit publik, miratuar me udhëzimin nr 108 Dt.17.11.2016 ,”Per miratimin e manualit menxhimit finaciar dhe kontrollit”.

2.Gjetje Në referencë të nenit 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeversjen vendore” Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP dhe Drejtoria Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave , perpara krijimit te Drejtorise, duhej të kishin kryer studimin për Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme , Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit.

Ne reference te nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeversjen vendore” këshilli bashkiak duhej të kishte marrë vendim për krijimin e Drejtorisë, shoqeruar me strukturen dhe fondet perkatese.

Ne reference te pikes nenit 3, 8,12, 16 të Ligjit 48/2016 “Për Pyjet dhe shërbimin Pyjor” duhej te ishte percaktuar qarte Njësia Përgjegjese e administrimit të pyjeve,duhej te ishte miratuar planin e shfrytëzimit të pyjeve,duhej te ishte ngritur struktura e Policise Pyjore, duhej te ishin dokumentuar rastet e “vendim Kundravajtje”

Nga auditimi auditimi kryer ka rezultuar se nuk është kryer studimin për Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme , Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit. Drejtoria nuk është krijuar me Vendim të veçantë të Këshillit Bashkiak. Nuk është percaktuar Njësia Përgjegjese e administrimit të pyjeve, nuk eshte hartuar dhe miratuar planin e shfrytëzimit të pyjeve, nuk është ngritur struktura e Policise Pyjore, si dhe nuk është dokumentuar asnjë rast “vendim Kundravajtjet” .

Rekomandim Te behet kerkese me shkrim prane Bashkise Shkoder për”

- Përcaktimin e përgjegjësisë për Drejtorinë e Bujqësisë, për Drejtorinë e shërbimeve Bujqësore e pyjore.
- Percaktimin e Njesise Pergjegjese per administrimin e pyjeve,per hartimin dhe miratimin e planit te shfrytezimit te pyjeve.
- Ngritjen e struktures se policise Pyjore.

3.Gjetje Ne reference te nenit 8 te ligjit Nr. 48/2016 “Per shërbimin Pyjor”, nenit 27 te ligjit 139/2015 PËR “Për vetëqeverisjen Vendore”, duhej te kishte mirëmbajtur dhe te bente te mundur funksionimin e infrastrukturës në fondin pyjor bashkiak, si dhe duhej te ishte administruar, shfrytëzuar dhe mirëmbajtur infrastruktura e ujitjes dhe kullimit.

Drejtorja e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore nuk ka realizuar nje vlerësim të situatës së fondit pyjor dhe te infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, si dhe nuk ka ndërmarre veprime konkrete për përmirësimin e situates.

Rekomandim Ne bashkepunim me Drejtorine Drejtorja e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave dhe Drejtorine e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP, te behet nje vleresim i përgjithshëm i situates se fondit pyjor dhe infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, si dhe të përcaktohet planveprimi i ndërhyrjeve.

4.Gjetje Referuar neneve 9, 23,24, të ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiare dhe kontrollin”, duhej te ishte kryer informimi i organeve eprore si dhe duhej te ishte ngritur sistemi i monitorimit, ndersa nëpunesi autorizues nuk ka informuar me shkrim te pakten ne fund te vitit ushtrimor lidhur me funksionimin e kontrollit te brendeshem, duke vepruar ne kundërshtim me nenin 9, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Rekomandim Ngritjen dhe funksionimin e sistemit te informimit dhe monitorimit, si dhe kryerjen e dokumentimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e eficencës se institucionit.

5.Gjetje Referuar nenit 138 dhe 141 të Ligjit 136/2015 Kodi Punes “Transferimi i Ndërmarrjes, ruajtja e të drejtave dhe kohëzgjatja punë”, duhej të transferohej asetet e ndermarrjes së bashku me personelin, konkretishtë 12 nëpunës te sektori Ujitjes e Kullimit, si dhe nuk duhej të zgjidhej kontrata pa njoftim paraprak, si dhe pushimi nga puna i punëmarrësit nga punëdhënësi duhej të bëhej në respektim të afateve referuar vendimit të transferimit të ndërmarrjes.

6.Gjetje Referuar nenit 12 te ligjit nr. 9761 date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, duhej lidhur kontrata pune për punonjësit me kohë të pjëseshme. Për periudhën audituese për punonjësit me kontratë nuk janë lidhur kontrat pune.

Rekomandime

a. Drejtorja e Përsoneleit prane Bashkisë dhe nëpunësi Autorizues i Drejtorsë se Shërbimeve Bujqësore e Pyjore te përcaktojë ndarjen dhe dokumentimin e detyrave funksionale të cdo punonjësi, të bëhet raportimi i punës, si dhe përshkrimi i vendeve të punës.

Të plotesohen dosjet e punonjesve ,te listuar dhe nenshkruar nga zyra personelit, të kryhet vlersimi i punes se punonjesve, kualifikimi i punonjesve me program dhe i dokumentuar.

b. Drejtoria e Përsonelit prane Bashkisë dhe nëpunësi Autorizues dhe zbatues i Drejtorisë se Shërbimeve Bujqësore e Pyjore te miratojë nga Kryetari i Bashkisë listën emërorë të përsonelit sipas vendimeve të Titullarëve dhe struktures organike te miratuar me vendim nr 605 datë 1.09.2016 Këshillit Bashkiak .

c. Drejtoria e Përsonelit prane Bashkisë dhe nëpunësi Autorizues dhe zbatues i Drejtorisë se Shërbimeve Bujqësore e Pyjore të lidhe kontratat e punës për të gjithë personelin me kohë të pjesëshme.

7.Gjetje Ne reference te pikes 263,te udhezimit Nr.02 DT.06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” duhej te ishte perpiluar dhe miratuar gjurma e auditit per zbatimin e buxhetit, per zbatimin e buxhetit nuk është bere miratimi i gjurmes buxhetit si dhe nuk është bërë përpilimi i saj.

Rekomandim Te kerkohet me shkrim, prane Drejtorise Planifikimit buxhetit ne Bashki per te marre asistencen e nevojshme per perpilimin e zbatimin e gjurmës auditit per buxhetin.

8.Gjetje Ne reference te VKM Nr. 438 date 08.06.2016 dhe V.K.M nr.391, date 21.06.2006, duhej te ishin planifikuar dhe vjelur tarifa për materialet drusore, dhe jo drusore ndërsa nga auditimi në fakt rezultoi se nuk janë bërë përpjekje për planifikim dhe vjelje te tarifave .

Rekomandim

a. Në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër të bëhet studimi dhe me pas planifikimi i mundesise se arketimit te tarifave per materialin drusor dhe jodrusor,si dhe të hartohen procedurat e arketimit të tarifave.

b. Te mbahen akt-rakordime me drejtorine e te Ardhurave çdo muaj per arketimin e tarifave per sherbimet e kryera,sipas llojit.

9.Gjetje Në reference të lidhjes 9 të V.K.M nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeversjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijeve te pagave të funksionareve të zgjedhur e te emruar, nepunesve civile e te punojesve administrativ të njësive të qeverisjes vendore”, paga e grupit duhej te llogaritur, bazuar ne diplomen e fituar, nga auditimi i kryer ka rezultur se per 4 punonjes nuk perputhej diploma e fituar me pagen e grupit.

10. Gjetje Ne reference te pikes 3 te V.k.M nr. 455 datë 18.07.2007 “Për pagat dhe shtesat mbi page te punonjesve të sherbimit Pyjor” i ndryshuar, per punonjesit pyjor , shtesa per funksion duhej te paguhej ne masën 10% te pages baze, nga auditimi i kryer ka rezultuar se

per kater punonjes shtesa per funksion është llogaritur 10 % të pages baze pergjegjesit te sektori.

11 .Gjetje : Në reference te nenit 83 te ligjit nr. 7961 date 12.07.1995 “Kodi i punes Republikes Shqiperise” i ndryshuar kreu I i V.K.M nr. 511 date 24.10.2002, “Për kohëzgjatjen e e punës e pushimit ne institucionet shteterore” i ndryshuar. Punonjesi punon 174 ore ne muaj ose 22 dite, nga auditimi i kryer rezultoi se per 13 punonjes jane kryer llogaritje te pagave per 29 dite pune. .

12 Gjetje: Referuar V.k.M nr. 511 date 24.10.2002 ndryshuar V.K.M nr. 463 date 16.06.2011 “Per kohezgjatjen e punes e pushimit në institucionet shteterore” me kërkesë te eprorit te drejtperdrejte dhe me miratim te titullarit te institucionit Qendror ,punonjesit te administrates publike mund ti kërkohet te kryeje ore shtese.Orët shtese kompensohen me pushim,vetëm ne rastet kur është e pamundur dhenie e pushimit për orët shtese ,nepunësi ose punonjesi i administraës ka te drejte te kompensohet me shtese mbi pagen normale.Kompensimi i oreve shtese te duhej te ishte bërë me pushim.Nga auditimi rezultoi se është bërë pagese shtese mbi pagen normale,për orët shtëse dhe nuk është kompensuar me pushim,.

Nga auditimi i procesit te rillogaritjes pagave ka rezultuar se jane paguar me teper 20 punonjes per vlere 324.967 lek përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm efektiv.

13 Gjetje: Në referencë të pikes 69 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik” i ndryshuar. Nepunesi autorizues duhej te kishte perpiluar list prezencen e punonjesve dhe me pas nepunesi zbatues mbi bazen e list-prezence te bente llogaritjen e pagave, nga auditimi i kryer rezultoi se nuk eshte perpiluar list-prezenca e punonjesve.

14 Gjetje : Në reference të pikes 2 te V.k.M nr. 594 date 22.12.1997 “Per regjistrin që mban punëdhënësi për punemarresin e tij”. Duhej te ishte perpiluar regjistri i pagave per punemarresit, nga auditimi i kryer rezultoi se ky liber nuk është plotësuar.

Rekomandime:

a.Te behet rillogaritja e pagave për të gjithë punonjësit nga momenti i krijimit deri me 31 Tetor 2017, dhe pas rillogaritjes të bëhet sistemimi i diferencave , duke bërë ndalesën për punonjesit që kanë përfituar me teper.

b. Çdo fund muaji te përpilohet list-prezenca dhe te nenshkruhet nga pergjegjesi i burimeve njerezore dhe drejtori, me pas, mbi bazen e list-prezencës te llogaritja e pages .

c. Për të gjithë rastet kur për nevojat e punës, kërkohet puna mbi kohen normale të punës, të bëhet miratimi nga organet eprore dhe puna e kryer jashte kohës normale të punës të kompensohet me ditë pushimi.

d. Te bëhet plotesimi i librit pagave sipas formatit miratuar.

15. Gjetje.Referuar pikave 3,4,7 neni 2 , pika 3/c neni 11 neni 40 te VKM nr 914 date 29.12.2014”Rregullat e prokurimit Publik”, Drejtuesi i institucionit duhet te sqaroje arsyen e kryerjes se shpenzimit, bashkangjitur specifikimet e mallit ose te sherbimit,si dhe faturat duhet te nenshkruhen nga te gjithë anetaret e komisionit.Në kontratë duhet përcaktuar afati dhe grafiku i punimeve. Sasia e drureve te prere duhej te ishte bere hyrje ne magazine e me pas te shitej si lende drusore per popullaten.

Referuar VKM nr 538 datë 26.05.2009 “ Për licencat dhe lejet që trajtohen nëpërmjet QKL dhe disa rregullime te tjera nënligjore të përbashkëta”, Operatori ekonomik fitues duhej të kishte licensë III 7A për shërbimet e ekspertizës dhe /ose profesionale lidhur me pyjet dhe kullotat, ndërsa operatori fitues është i licensuar II 8b “shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore.

Rekomandim Të kërkohej asistencë pranë bashkisë Shkodër për organizimin dhe kryerjen e procedurave të prokurimit publik

16. Gjetje Ne referencë te nenit 6,7 te ligjit nr 9228 date 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,duhej të ishin berë rregjistrimet kontabile të justifikuara me evidence mbështetëse,si dhe ne fund te vitit duhej bërë vlerësimi i aktiveve dhe te paraqitej në pasqyrat financiare vjetore. Ka mangesi ne kryerjen e regjistrimeve kontabile ne perpilimin e evidencave kontabile, ne pasqyrimin me vertetsi te gjendjes ne pasqyrat financiare.

17. Gjetje Ne referencë të pikave 5-9 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar duhej përpiluar një regjister i rrishtit lidhur me menaxhimin e asetëve .Nga auditimi rezultoi se nuk është hartuar rregullorja për menaxhimin e asetëve.

18. Gjetje Në referencë të nenin 7 te ligjit nr 9228 date 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve duhej te ishte paraqitur me vërtetësi dhe besueshmëri ne pasqyrat financiare vjetore.Nga auditimi rezultoi se gjendje e magazinës për lëndën djegëse nuk është pasqyruar ne pasqyrat financiare vjetore.

Rekomandime

- a. Ti kërkohej me shkrim bashkisë Shkodër, për venien në dispozicion te rregullores se asetëve te miratuar nga Kryetarja e Bashkisë ,si dhe te kërkohej asistencë per menaxhimin e asetëve.
- b. Ne hartimin e pasqyrave financiare për vitin 2017 te behet sistemimi për aktivet duke ju referuar gjetjeve te raportit te auditit.
- c. Për të gjitha lëvizjet e asetëve të lëshohet urdhër dorëzimi, pas daljes se mallerave të bëhet menjehere dokumentimi me fletë dalje.
- d. Per mallerat me furnizim elektronik administrimit të bëhet nga përgjegjësi material.

19. Gjetje. Nga auditimi i procesit të transferimit ,referuar pikave 2 /66 vkm 433 datë 8.06.2016 nga Ministrija e Mjedisit duhej të transferohej Drejtorisë Shërbimeve Bujqësore e Pyjore : 1-Të drejtave e detyrimeve të personave fizik e juridik të fituara me kontratë ekzistuese për marrjen në përdorim të sipërfaqeve fondit pyjor e kulloror.

2-Regjistrimi i sipërfaqeve të fondit pyjor e kulloror në ZRPP Shkoder. Saktësishtë në dosje mungojnë kontratat me të tretët dhe dokumenti drejtuar ZRPP Shkodër për regjistrim të pyjeve e kullotave.

Nga auditimi rezulton që pikat 2 dhe 66 të VKM nr 433 datë 8.06.2016 nuk kanë gjetur zbatim,konkretishtë nuk kemi asnjë kontrate të marrë në dorezim,të dokumentuar dhe nuk është realizuar procesi i regjistrimit të sipërfaqeve të fondit Pyjore e Kullorore.

Rekomandime

Drejtoria e Pyjeve e Kullotrave prane Bashkisë , si dhe administrata e Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore e Pyjore të kontrollojnë territorin për verifikim të zenieve të siperfaqeve pyjore e kullore nga te trete,ti kërkojne Ministrisë Mjedisit administrimin e kontratave me të trete.

Të fillojne menjëherë procesi i regjistrimit të sipërfaqeve te pyjeve dhe kullotave në territorin e Bashkisë Shkodër.

20. Gjetje_Nga auditimi i procesit të transferimit ,referuar pikave 1/b,d;5 , tabelave 2,3,5 ,6 vkm 1108 datë 30.12.2015 nga Bordi Kullimit duhej të transferohej Bashkisë Shkodër :

Asetet e paluajtshme pjesërishtë,makineri e paisje, përoneli i transferuar me fondin e pagave për 12 punonjes.

Nga auditimi rezulton që pikave 1/b,d;5 , tabelave 2,3,5 ,6 vkm 1108 datë 30.12.2015 nuk kanë gjetur zbatim, konkretishtë nuk kemi transferim të saktë te asteve të qendrueshme,objektet pjesërishtë jane te zena, makineria e rendë nuk është marrë në dorëzim,si dhe personeli prej 12 punonjes të sektorit të ujitjes nuk është transferuar .

Rekomandim Administrata e Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore e Pyjore dhe Drejtoria Juridike dhe Aseteve të verifikojë ,të transferoje dhe regjistroje asetet e Bordit të Kullimit ne pronsi Bashkisë Shkodër.

Administrata e Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore e Pyjore dhe Drejtoria e Përsoneleit të ndjeke dhe përpilojë emërimet,largimet listen e personelit në përputhje me strukturen organike të miratuar nga Titullaret e Bashkisë dhe te Këshillit Bashkiak

Njesia Auditimit Brendshem

Bashkia SHKODER

